

http://lajmpress.com/top_lajme/34447.html

[Fillimi](#) | [Top Lajme](#) | Shkencëtarë nga Maqedonia regjistrojnë kërpudhat në Shqipëri

Shkencëtarë nga Maqedonia regjistrojnë kërpudhat në Shqipëri

Madhësia:



Ekipi i udhëhequr nga Profesor Mitko Karadelev nga Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore në Shkup tashmë është duke punuar një kohë në projektin 'Kërpudhat e Shqipërisë: Verifikimi (përcaktimi) i listës së kërpudhave dhe Listës së kuqe preliminare (paraprake) si dhe propozimi i regjioneve të rëndësishme të kërpudhave në Shqipëri' (1 prill 2013 - 30 shtator 2014), mbështetur nga Fondacioni "Raford" të Anglisë. Ekipi mbështetet në përvojën e tij në lidhje me Listën e Kuqe, të fituar në një projekt të ngjashëm për ruajtjen e kërpudhave e zbatuar në Maqedoni.

“Deri më tani, kërpudhat e Shqipërisë ishin të studiuar shumë pak, dhe kishte informacione zyrtare mjaft të rralla rreth tyre. Vendi nuk disponon me përshkrim të kërpudhave as me listë të kuqe. Mungon Legjislacioni për mbrojtjen e kërpudhave edhe pse eksportohen sasi të medha të kërpudhave. Duke iu faleminderuar Shumellojshmërisë së klimës, tipeve vegetative dhe substrateve, pritej një diversitet i lartë i kërpudhave, kurse me projektin u konfirmuan këto pritje. Janë marrë të dhëna për rreth 600 lloje të kërpudhave dhe më pas u formua një bazë e të dhënave për të gjitha llojet e kërpudhave të identifikuara në Shqipëri, që është në dispozicion online (<http://macfungi.eebs.com/fungialbanici.htm>). Projekti përfshin edhe ngritjen e vetëdijes publike përmes ligjëratave përpara banorëve vendor si dhe zyrtarëve relevante Shqiptare, mbi këtë çështje dhe shpërndarjen e materialeve promovuese”, thuhet në njoftimin e këtij fakulteti.

Studimet e shumta në terren janë kryer në më shumë se 30 vende në pjesë të ndryshme të vendit, kryesisht në parqet nacionale: Valbonë, Hotovës Prespë, Llogarë, Dajtë, Shebenik-Jabllanicë, Korab-Koritnik dhe Tomor. Lista e parë paraprake e kërpudhave, përgatitur në përputhje me

kriteret e IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës-UNRN), është gati dhe u paraqit në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare e Ekosistemeve në Tiranë ICE-2014 (23-26 Maj-2014). Do të propozohen edhe fusha të rëndësishme të kërpudhave (FRK), në varësi nga prania e specieve të rralla dhe të rrezikuara, pasuria dhe rëndësia mikologjike e habitateve.

Lista do të jetë bazë për përpilimin e një Liste të Kuqe zyrtare të kërpudhave dhe përgatitjen e legjislacionit për mbrojtjen e kërpudhave. Aktivitetet e këtij projekti mund të futen më tej në Strategjinë Kombëtare Shqiptare dhe Planit Aksionar për Biodiversitetin. Ekzemplar reprezentues të kërpudhave do t'i dhurohen Muzeut Shkencor-Natyror në Shqipëri apo ndonjë institucioni të interesuar me qëllim të krijimit të një Koleksioni Kombëtar të Kërpudhave të Shqipërisë.

The logo features the word "Lajm" in a large, bold, white sans-serif font against a solid red rectangular background. Below "Lajm", the word "MAQEDONI" is written in a smaller, white, all-caps sans-serif font.